VENDIM
Nr.464, datë 16.4.2008

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME, PËR KOMUNËN FAN, PËR REALIZIMIN E PROCEDURAVE PËR ZHVENDOSJEN E VARREZAVE NGA FSHATI I KLOS NË QENDËR FAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8, të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Trasportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, për komunën Fan, t'i shtohet fondi 6 466 780 (gjashtë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë, për realizimin e procedurave për zhvendosjen e varrezave të fshatit Klos në Qendër Fan, si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash, pjesë e autostradës Durrës-Kukës-Morinë.
2. Ky fond të përballohet nga "Llogaria speciale", e krijuar si transfertë kapitale për t'u përdorur për shpronësimet.
3. Procedurat për zhvendosjen e varrezave të fashtit Klos të përfundojnë brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për livrimin e fondit përkatës.
5. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe komuna Fan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha